



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:118524

Datë: 06.12.2022

Numri i dokumentit: 03721188

**P.nr.627/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm**, me Gjyqtarin individual Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taranish, në çështjen penale, kundër të akuzuarve L.L. dhe L.1 L., që të dy nga Peja, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, "lëndim i lehte trupor", nga neni P. par. 1, nën par. 1.4 e lidhur me nenin 31, të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjen PP/II Nr. 455/20, të datës 17.09.2020, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor gjyqësor me dt. 07.11.2022, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Lumturije Hoxha, të pandehurve: L.L. dhe L.1 L., të dëmtuarit B.C., të njëjtën ditë me dt. **07.11.2022**, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.06.12.2022, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

***Të akuzuarit:***

**L. L.**, i lindur me .... ne P, ku edhe banon ne rr. "H. C." nr. . -P., i biri i R., dhe i nënës F., e lindur B., student i fakultetit juridik, i pamartuar, i gjendjes se mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal ....., posedon numrin e telefonit .../...-..., i etnitetit Shqiptar, shtetas Kosovar, mbrohet në liri,

**L.1 L.**, i lindur me .... ne Peje, ku edhe banon ne Rr. "H. C.", nr. . -P/, i biri i R., dhe i nënës F., e lindur B., student i fakultetit juridik, i pamartuar, i gjendjes se mesme ekonomike, i identifikuar ne baze te letërnjoftimit me numër ....., posedon numrin e telefonit .../...-..., i etnitetit Shqiptar, shtetas Kosovar, mbrohet ne liri,

**JANË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Me dt. 02.03.2020 rreth orës 10:00, ne rr. "B. K." ne Peje, duke vepruar si bashkëkryerës, tjetrit i shkaktojnë lëndime te lehta trupore me pasoja te përkohshme ne shëndet dhe atë te dëmtuarit B. C., ne atë mënyre qe, përderisa i dëmtuari, ishte ne shoqërinë e mikut tij I. K. dhe me te arritur ne afërsi te disa kioskave qe ndodhen ne afërsi te pemishtes "T. D.", te pandehurit e kane thirr te dëmtuarin dhe me tu kthyer ai për te shikuar se kush po e thërret, te njëjtit menjëherë e kane

sulmuar atë duke e godite me boks dhe shkelma ne pjese te ndryshme te trupit dhe ne koke, i njëjti është rrezuar ne trotuar, ashtu qe si pasoje e goditjeve te marra, i dëmtuari i lartcekur pëson lëndime te lehta trupore, pas sulmit fizik qe i kane bere te dëmtuarit, te njëjtit i drejtohen me fjalët "*Se kem me te lilkfidu dhe se i gjalle nuk hyn ne atë prone*", dhe largohen nga aty,

- me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, "Lëndim i lehte trupor", nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4, e lidhur me nenin 31, të KPRK-së.

Andaj gjykata, ne bazë te nenit 7, 17, 21, 38, 39 par. 1 nën par. 1.1, 40 par. 1 nën par. 1.3, 43, 44, 69, 70, 71 par. 1 nën par. 1.3, 72 nenit 184 par. 2 te KPRK-së, nenit 365, 366, 453, 463 par 2 te KPPRK-ës, të akuzuarit L.L. dhe L.1 L. e:

## G J Y K O N

- I. Të pandehurin **L. L.**, me dënim me gjobe në shumë prej shtatëqind e pesëdhjete (750) euro, e të cilin dënim i njëjti obligohet ta paguaje në afat prej tridhjete (30) ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prere.
- II. Të pandehurin **L.1L.** me dënim me gjobë në shumë prej shtatëqind e pesëdhjete (750) euro, e të cilin dënim i njëjti obligohet ta paguaje në afat prej tridhjete (30) ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prere.
- III. Nëse të pandehurit, dështojnë, refuzojnë apo nuk dëshirojnë ta pagujnë dënimet e shqiptuara me gjobë si në piken I dhe II të këtij aktgjykimi, të njëjtat do ti shndërrohen në dënim burgimi duke i llogaritur shumen prej njëzetë (20) euro, për një ditë burgimi.
- IV. Të pandehurit L.L. dhe L.1 L. lirohen nga paguarja e shpenzimeve të procedurës penale si dhe taksës për kompensimin e viktimave të krimit, meqenëse janë studentet.
- V. I dëmtuari B. C. për realizmin e kërkesave pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti i përgjithshëm, me dt. 17.09.2020 ka ngritur aktakuzën nen shenjen PP/II Nr. 455/20, kundër të akuzuarve L.L. dhe L.1 L., që të dy nga Peja, për shkak të veprës penale "*Lëndim i lehte trupor*" nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, me datë 22.11.2021. Gjatë asaj seancë, në prezencën e Prokurorit të Shtetit dhe të pandehurve L.L. dhe L.1 L., të pandehurit secili veç e veç, pas njoftimit me drejtat dhe detyrimet e tyre, janë deklaruar **të pafajshëm** për veprën penale me të cilën ngarkohen.

Pas kësaj, gjykata konform nenit 245 par. 6 të KPPRK-së, të njëjtit ka udhëzuar që në afat prej 30 (tridhjete) ditësh kanë të drejte që ta paraqesin kundërshtimin e provave, kërkesën për hedhje të aktakuzës, si dhe propozime tjera.

Me dt. 06.12.2021 në këtë gjykatë, nga mbrojtësja e të pandehurit: L. L., av. M. L. nga Prishtina, është pranuar kërkesa për hedhjen e aktakuzës si dhe kundërshtimi i provave, për shkak të pa bazueshmërisë dhe kundërligjshmërisë se kësaj aktakuze në raport me veprën penale duke i propozuar gjykatës që aktakuza të hedhet poshtë dhe të bëhet pushimi i procedurës penale ndaj të pandehurit L.1 L..

Gjykata me dt. 31.12.2021 ka marrë Aktvendim nën shenjen P.nr 627/20 me të cilin ka refuzuar kërkesën e mbrojtëses së të pandehurit L.1 L., av. Marigona Lajqi, si e pabazuar, ndërsa të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës janë të pranueshme dhe do të jenë objekt shqyrtimi.

Kundër këtij Aktvendimi, me dt. 10.02.2022 në këtë gjykatë është paraqitur ankesa nga ana e mbrojtëses av. M. L., drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

Gjykata e Apelit në Prishtinë, duke vepruar sipas ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtëses av. Marigona Lajqi, me dt. 07.04.2022 ka marrë Aktvendim nën shenjen PN. nr. 307/2022 me të cilin ka refuzuar ankesën e mbrojtëses si e pabazuar.

Pas kësaj, gjykata me dt. 07.11.2022 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën kanë qenë prezentë Prokurorja e Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë, departamenti i Përgjithshëm, të pandehurit L.1L. dhe L.L. si dhe i dëmtuari B. C..

Në këtë seance të shqyrtimit kryesor, pas leximit të aktakuzës nën shenjen PP/II Nr. 455/20 dt. 17.09.2020 të akuzuarve konform nenit 325 të KPPRK-së ju është dhënë mundësia që prapë të deklarohen për fajësinë apo pafajësinë e tyre.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarit për rëndësinë dhe pasojat, kushtet dhe privilegjet e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari **L.L.** ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije **e pranon fajësinë**, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës, i vjen keq për veprimet e tij, po ashtu i pandehuri **L. L.** ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije **e pranon fajësinë**, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës, i vjen keq për veprimet e tij.

Në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve L.L. dhe L.1 L., gjykata ka marrë mendimin e palëve tjera në procedure.

Prokurorja e Shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar se: *pajtimi i fajësisë i plotëson kushtet ligjore, gjykatës i propozoj ë të aprovoje pranimin e fajësisë pasi që ky pranim i fajësisë është i mbështetur në provat që gjenden në shkresat e lëndës.*

I dëmtuari B. C. në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar së: pajtohem me deklarinimin e prokurores që ky pranim i fajësisë nga ana e të pandehurve ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe po ashtu pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve dhe i propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovon.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve L.L. dhe L.1 L., vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarve, pasi që të njëjtit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pasi që pranimi i tyre i fajësisë gjën mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe po ashtu është bërë konform

dispozitive përkatëse ligjore, nga neni 248 par. 1 nën par. 1.1 e gjerë në 1.4 e lidhur me nenin 326 të KPPRK-së.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata me Aktvendim procedural e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, ngase pranimi i fajësisë gjen mbështetje me provat formale - materiale të bashkangjitura në aktakuzë siç janë: *raporti i oficerit policor Xh. M. te dt. 02.03.2020, deklarata e te dëmtuarit B. C. e dhënë ne polici me dt. 02.03.2020, deklarata e te dyshuarit L. L. e dhënë ne polici me dt. 04.03.2020, deklarata e të dyshuarit L.1 L. e dhënë ne polici me dt. 04.03.2020, deklarata e dëshmitarit I. K. e dhënë ne polici me dt. 02.03.2020, raporti nga Spitali i përgjithshëm Peje -Emergjencia me nr. te protokollit ....., akt ekspertimi mjeko-ligjor i dt. 03.09.2020 si dhe ne shkresa tjera te lëndës, andaj duke pas parasysh faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 248 par. 1 nën par. 1.1 e gjerë në 1.4 të KPPRK-së, atëherë ne ketë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të të pandehurve se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 326 par. 4 të KPPRK-së ka vazhduar me fjalën përfundimtare dhe shqiptimin e dënimit.*

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: *pasi që të pandehurit kanë bërë pranimin e fajësisë mua nuk me mbetet asgjë tjetër përpos që gjykatës ti propozoj që të njëjtit ti shpall fajtor, te dënoj sipas ligjit si dhe ta obligoj ne paguarjen e shpenzimeve të procedues penale dhe gjithashtu gjykatës i propozo që të ketë parasysh se marrjes se vendimit mbi dënimin si rrethana renduese te merret fakti se i pandehi L.1 L. pasi që ka kry veprën penale për të cilën jemi këtu menjëherë ka kryer edhe një vepër tjetër ne të njëjtën çështje ndaj të dëmtuarit të njëjtë duke përdorur mjetin e rrezikshëm – thikën e për të cilin kemi ngritur aktakuzën PP/II Nr. 2337/2020 dt. 18.01.2021, andaj ne rastin konkret konsideroj se nuk ka vend për rrethana lehtësuese. Ne shkresat e lëndës nuk posedoj ndonjë aktgjykim të plotfuqishëm ne raport me të pandehurit por gjykata mund të verifikojë këtë dhe i propozoj gjykatës një gjë të tillë, ndërsa ju dorëzoj një kopje të aktakuzës të cilën e kam potencuar, dhe ka të bëjë me të njëjtën ditë, mirëpo e vërteta është që nuk është mbajtur gjykimi në këtë çështje.*

I dëmtuari B. C. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: *e mbështes në tërësi prokuroren dhe fjalën e saj përfundimtare.*

I pandehuri L. L. ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se: *me vjen keq që ka ndodhur, jam penduar shumë, jam ne gjendje me kerku falje të dëmtuarit, me lejen e gjykatës i drejtohet të dëmtuarit dhe i kërkon falje për veprimet e bëra. I premtoj gjykatës që nuk do ta përsëris veprimet e tilla, ndaj të dëmtuarit por as ndaj të askujt, e lus gjykatën që të me shqiptojë një dënim sa më të butë.*

I pandehuri L.1L. ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se: *kërkoj falje edhe gjykatës po ashtu edhe të dëmtuarit për rastin që ka ndodhur, me vjen keq, lus gjykatën që të ketë parasysh që të dy jemi student dhe ndonjë dënim i rende do të na dëmton, ndërsa ne lidhje me rastin që e përmendi prokurorja se ka një aktakuzë, vëllai im ka qenë i dëmtuar në këtë rast e lus gjykatën që të me shqiptojë një dënim sa më të butë.*

Andaj, me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, rrjedh se në veprimet e të akuzuarve, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale **“Lëndim i lehte trupor”** nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se tek të pandehurit ka ekzistuar dashja, që veprën penale ta kryejnë në mënyrë të përshtatshme si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që të pandehurit kanë qenë të vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e kanë dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Gjyqtari individual në aplikim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara e të përmendura nga ana e palëve në procedure gjatë seancës të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin L. L. gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetshme, keqardhjen e tij, po ashtu pendimin e tij për veprën e kryer, kërkim faljen e tij ndaj të dëmtuarit, moshën e tij të re, mosdenueshmerine e tij të mëparshme, ndërkaq nga rrethanat rënduese gjykata në rastin konkret për të pandehurin gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale e cila është kryer në rrugën e qytetit, ndërsa në raport me të pandehurin L.1 L. gjykata si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetshme, keqardhjen e tij, po ashtu pendimin e tij për veprën e kryer, kërkim faljen e tij ndaj të dëmtuarit, moshën e tij të re, mosdenueshmerine e tij të mëparshme, ndërkaq nga rrethanat rënduese gjykata në rastin konkret për të pandehurin gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale e cila është kryer në rrugën e qytetit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarit e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me gjobë të pandehurve, u morr konform nenit 43 e lidhur me nenin 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së.

Vendimi për zëvendësimin eventual e dënimit të shqiptuar me gjobe me dënim burgimi në rast se të pandehurit dështojnë, refuzojnë apo nuk dëshirojnë ta paguajnë dënimin me gjobë u morr konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për lirimimin e të pandehurve nga paguarja e shpenzimeve të procedurës penale është marrë konform nenit 453 par. 4 të KPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontestin e rregullt civil u morr konform nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.627/20 dt.06.12.2022**

Zyrtari ligjor

---

Gjyqtari i vetëm gjykues,

---

**Alan Taranish**

**Murat Hulaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.